VENDIM
Nr. 164, datë 12.3.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 440, DATË 17.5.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE, TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 33/1, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 440, datë 17.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e standardeve, të kritereve dhe procedurave të akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Kudo në përmbajtjen e vendimit, fjalët "... Qendra Kombëtare e Edukimit (në vijim, QKEV) ..." zëvendësohen me "... Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, (në vijim, ASCK) ...".

2. Në ndarjen V bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në pikën 1, në fund të fjalisë së parë, pas fjalëve "... të kufizuar ose të pakufizuar ..." shtohen "... në shërbimin *on-line*, që ofrohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, nëpërmjet portalit "*e-Albania*" ...";

b) Në pikën 2, fjalët "... të dorëzojë në QKEV ..." zëvendësohen me "... të ngarkojë në shërbimin *on-line*, që ofrohet nga ASCK-ja, nëpërmjet portalit "*e-Albania*" ...".

3. Fjalia e dytë, e ndarjes VIII, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Çdo ankesë paraqitet në shërbimin *on-line*, që ofrohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, nëpërmjet portalit "*e-Albania*" dhe shoqërohet me të dhëna e argumente që mbështesin ankimin.".

4. Pas ndarjes IX shtohet ndarja X, me këtë përmbajtje:

"X. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë në proces shqyrtimi nga struktura përkatëse e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, në kohën e paraqitjes së tyre.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku